34. **Fondi nr.4, Drejtoria e I, Viti 1983, Dosja nr.121** “Informacion i zv.ministrit të punëve të jashtme për vendimin e SHBA ndaj çështjes së Kosovës, 18.10.1983”, me 2 (dy) fletë. Dokumentet datojnë në vitin 1983. Niveli i klasifikimit “Sekret”.
35. **Fondi nr.4, Drejtoria e I, Viti 1981, Dosja nr.72** “Informacion dërguar udhëheqjes Partisë e Shtetit mbi gjendjen në Kosovë, komentet për situatën atje dhe personat e ardhur nga krahinat shqiptare në Jugosllavi pas demonstratave të Kosovës”, me 24 (njëzet e katër) fletë. Niveli i klasifikimit “Sekret”.
36. **Fondi nr.4, Drejtoria e I, Viti 1981, Dosja nr.71** “Informacion dërguar udhëheqjes Partisë e Shtetit mbi komentet e diplomatëve të vendeve kapitaliste-revizioniste mbi gjendjen në vendin tonë dhe ngjarjet në Kosovë”, me 41 (dyzet e një) fletë. Niveli i klasifikimit “Sekret”.

37. **Fashikull nr. 12191**, në ngarkim të **B. P.**, me 171 (njëqind e shtatëdhjetë e një) fletë. Niveli i klasifikimit të fashikullit është “Tepër Sekret”. Ky fashikull i përket fondit Kosova.
38. **Dosje O.R.V.** nr. 126, **T.O.B.**, me 2 fashikuj përkatësisht 8 (tetë) dhe 130 (njëqind e tridhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit ish Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.
39. **Dosje O.R.V.** Radio Televizioni Shqiptar, me 2 fashikuj përkatësisht 20 (njëzet) dhe 340 (treqind e dyzet) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit ish Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.
40. **Dosje O.R.V.** nr. 133, Kinostudio “Shqipëria e Re”, me 2 volume përkatësisht 11 (njëmbëdhjetë) dhe 150 (njëqind e pesëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të fashikullit është “Sekret”. Dosja i përket fondit ish Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.
41. **Dosje formulare nr. 42980**, në ngarkim të **L. L.** me tri volume me 555 (pesëqind e pesëdhjetë e pesë) fletë në total. Dosja i përket Fondit Ish Dega XIII.

KRYETARE E KDZH-së

Gentiana Sula

Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me vendim nr. 7, datë 09.04.2021

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, i ndryshuar, kreu III, neni 13, pika b), dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, kreu III, neni 4, pika a), c), Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 13, datë 03.05.2018, të Kryetares së Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e plotë të dosjeve të klasifikuara “sekret shtetëror”, me Vendimin nr. 7, datë 09.04.2021, si më poshtë:

Fondi arkivor i ish-Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH


I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Dosje pune dhe personale nr. 13697, në ngarkim të **M. K.**, me 171 (njëqind e shtatëdhjetë e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”. Dosja i përket fondit ish Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

KRYETARE E KDZH-së

Gentiana Sula

**VEPRIMTARI TË AUTORITETIT
PËR INFORMIMIN
MBI DOKUMENTET
E ISH SIGURIMIT TË SHTETIT
PËR PERIUDHËN
MARS-PRILL 2021**



VEPRIMTARI TË AUTORITETIT PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH SIGURIMIT TË SHTETIT PË PERIUDHËN MARS-PRILL 2021

Prezantimi i raportit vlerësues për institucionet dhe procesin në Shqipëri për projektet rreth personave të zhdukur

Më 2 mars u prezantua raporti vlerësues për institucionet dhe procesin në Shqipëri i veprimtarive të projektit "Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për drejtësinë tranzitore dhe pajtuese: adresimi i çështjes së personave të zhdukur gjatë periudhës komuniste" i ICMP-AIDSSH, i mbështetur nga Bashkimi Europian.



Prezantimi i shoqatave fituese, të mbështetura nga Bashkimi Europian, në kuadër të projektit “Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për drejtësinë tranzitore dhe pajtuese: adresimi i çështjes së personave të zhdukur gjatë periudhës komuniste”, i zbatuar nga ICMP-AIDSSH

Projekti i Bashkimit Europian “Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për drejtësinë tranzitore dhe pajtuese: adresimi i çështjes së personave të zhdukur gjatë periudhës komuniste” i zbatuar nga ICMP-AIDSSH ka një linjë të rëndësishme për mbështetjen e shoqatave të të drejtave të njeriut dhe atyre në fushën e drejtësisë tranzitore.

Në faqet e AIDSSH janë prezantuar me radhë projektet e shoqatave fituese, të mbështetura nga BE, për t’u dhënë mundësi të gjithë familjarëve, dëshmitarëve apo të interesuarve për fatin e të

zhdukurve në diktaturë, të lidhen me organizatat, institucionet, të aplikojnë dhe të ndjekin aktivitetet përkatëse.

Fondacioni kujto.al



Arkiva Online e Viktimave të Komunizmit

Fondacioni kujto.al, Arkiva Online e Viktimave të Komunizmit, me kontribute të spikatura për zbardhjen e së shkuarës dhe komunikimin aktiv me shoqërinë, po punon për projektin “Pa varr”, shenjimi i vendvarrimeve në Shqipëri, dokumentar i bazuar në historitë e të afërmeve të të zhdukurve gjatë diktaturës”.

Projekti do të sjellë në vëmendjen e publikut, institucioneve shtetërore, organizatave të shoqërisë civile dhe studiuesve, çështjen e personave të

zhdukur gjatë diktaturës komuniste.

Sipas të dhënave zyrtare, ka rreth 6000 të zhdukur gjatë komunizmit, të cilët ende kërkohen nga familjarët. Autoritetet shtetërore duhet të përpiqen maksimalisht për të mundur gjetjen e trupave/mbetjeve mortore, si dhe ta njohin shoqërinë me krimet e diktaturës. Shqiptarët duhet të informohen në mënyrë të vazhdueshme dhe duhen ndërgjegjësuar për krimet e së shkuarës, nëpërmjet fakteve dhe dëshmimeve që e nxjerrin në dritë atë.

Bazuar në dëshmitë e të afërmeve ose personave që kanë të dhëna mbi zhdukjen e viktimave gjatë diktaturës, Fondacioni kujto.al synon të krijojë hartën digjitale të vendvarrimeve.

Po kështu, të realizojë një dokumentar ku të bëjë publike, për herë të parë, skemat e përdorura për zhdukjen e viktimave, bazuar në dokumente arkivore (me titra anglisht/shqip, duke rritur burimet edhe në gjuhë të huaj).

Projekti do t’u mundësojë studiuesve shqiptarë dhe të huaj informacion bazë mbi këtë fushë, lehtësisht të aksesueshëm, duke rritur ndërgjegjësimin e shoqërisë për krimet komuniste.

Instituti i Studimeve Politike



Instituti i Studimeve Politike

Instituti i Studimeve Politike ka veprimtari të ngjeshur me projekte të frytshme, si: Muzeu i Memories (2016-2020), Monitorimi i Parlamentit (2016-2021), Dekriminalizimi (2019-2022), Reforma në drejtësi (2017-2020), Monitorimi i proceseve zgjedhore (nga 2011), Monitorimi i partive politike (2018-2020), i procesit integruar (2017-2020), etj.

Projekti “Ata nuk janë më të humbur” synon të bëjë paraqitjen dokumentare të vuajtjeve dhe persekutimit gjatë regjimit

komunist dhe vështirësive që kanë hasur të përndjekurit për t’u integruar në shoqëri.

Dokumentari do të përshkruajë vendet kryesore të kampeve të vuajtjes apo përqendrimit, duke trajtuar raste të personave të zhdukur dhe kalvarin e familjarëve që ende i kërkojnë.

Gjithashtu, projekti synon të nxisë dialog institucional dhe shoqëror për gjetjen e të zhdukurve gjatë diktaturës, mbështetur në përkujtim dhe reflektim.

Duke hulumtuar aspektin ligjor dhe administrativ të trajtimit të personave të zhdukur në Shqipëri, duke pasqyruar vendet përkujtimore dhe treguar varrezat e mëdha, ku mendohet të jenë varrosur

shumë veta, ende të pagjetur, projekti synon të japë informacion të vlefshëm dhe lehtësisht të aksesueshëm për publikun, të tregojë çfarë është bërë dhe sfidat e ardhshme.

Po ashtu, të japë rekomandime për institucionet dhe rolin e tyre në këtë çështje, duke i inkurajuar për bashkërendimin e veprimtarive dhe bashkëpunimin me qytetarët e opinionin publik për të zhdukurit gjatë diktaturës.

Shoqata Antikomuniste e të Përndjekurve Politikë të Shqipërisë



Shoqata Antikomuniste e të Përndjekurve Politikë të Shqipërisë ka përvojë në ngritjen e memorialëve përkujtimorë në mbarë vendin, si Pogradec, Gjirokastrë, Tepelenë, etj.

Projekti i radhës synon të ndërtojë një memorial për të zhdukurit gjatë diktaturës në fshatin Ngurrëz, njësi bashkiake Krutje, Bashkia Lushnjë. Për realizimin e projektit janë kryer takime me banorë të zonës, familjarë të të zhdukurve dhe autoritetet lokale. Po ashtu, është tërhequr dokumentacioni përkatës në AIDSSH.

Palët e përfshira kanë shprehur dakordësi dhe gatishmëri për ngritjen e memorialit, i cili, sipas SHAPPSH do të vendoset në një nga zonat ku ka më shumë të zhdukur, të pushkatuar dhe të vdekur në burgje e kampe internimi në shkallë vendi.

Familjarët e viktimave, pasardhës të familjeve patriotike, nacionaliste në rrethin e Lushnjës, që më vonë u etiketuan "kulakë" nga regjimi, janë grupimi kryesor i interesuar, ku u jepet një vend për të bërë homazhe dhe për të nderuar të afërmit e tyre të zhdukur. Gjithashtu, sigurohet prania aktive dhe pjesëmarrja e pasardhësve e të mbijetuarve.

Qendra Shqiptare e Rehabilitimit të Traumës dhe Torturës



Qendra Shqiptare e Rehabilitimit të Traumës dhe Torturës, me kontribut 27 vjeçar në çështje të të përndjekurve politikë dhe integritet të tyre në

shoqëri, transparencës, trajtimit të dhunës dhe pasojave të saj, ekstremizmit, etj., nëpërmjet këtij projekti synon të organizojë të dhëna dhe informacione për statusin aktual të personave të zhdukur, në bashkëpunim me familjet dhe arkivat shtetërore e të tipologjive.

Po ashtu, të përgatisë dhe të botojë një analizë gjithëpërfshirëse për masat legjislative, gjyqësore dhe jogjyqësore që kanë të bëjnë me të drejtat e viktimave që kërkojnë drejtësi, rehabilitim dhe përkujtim.

QSHRT do të ofrojë këshillim ligjor për përpilimin e ankesave gjyqësore, si pjesë e një fushate gjyqësore publike, duke identifikuar mangësitë në gjyqësor dhe shkeljet e të drejtave civile. Projekti përfshin diskutime publike mbi propozimin e një ligji mbi viktimat (i cili jep përkufizim të gjerë të nocionit të viktimave dhe përshkruan të drejtat themelore që garantoohen për ta) me vëmendje të veçantë dhe përfshirje të fakulteteve të Historisë, Drejtësisë, dhe Gazetarisë.

Prania e të rinjve në tryezat e rrumbullakëta për të vërtetën dhe të drejtën për dëmshpërblim, kompensim dhe rehabilitim të viktimave të regjimit komunist, krahas institucioneve dhe shoqatave që vepronë në këtë fushë, synon nxitjen e debatit publik kombëtar mbi trashëgiminë e së kaluarës komuniste dhe kapërcimin e pasojave të saj të dhimbshme.

Shoqata e ish-të Përndjekurve Politikë të Shqipërisë me qendër në Shkodër



Shoqata e ish-të Përndjekurve Politikë të Shqipërisë me qendër në Shkodër ka aktivitet disavjeçar, kryesisht në zonën e veriut të vendit, për integrimin, rehabilitimin dhe përkujtimin e të përndjekurve politikë gjatë diktaturës.

Projekti i Shoqatës synon të kontaktojë familjet e të zhdukurve në komunizëm në Qarkun e Shkodrës për të identifikuar, veç personave të zhdukur në këtë qark, vendvarrimet e vendzekutimet përkatëse, të supozuara apo dokumentuara.

Po ashtu, të krijojë databazën sa më të plotë të të zhdukurve dhe familjarëve, trashëgimtarëve të tyre, me të dhënat përkatëse,

krahas databazës së vendvarrimeve/vendzekutimeve të raportuara në Qarkun e Shkodrës.

Në të njëjtën kohë, shoqata do të organizojë takime për veprim të përbashkët të familjeve të të zhdukurve dhe ceremoni nderimi dhe përkujtimi në vendzekutimet apo vendvarrimet e raportuara.

Shkodra dhe rrethinat e saj (ato që sot përfaqësojnë Qarkun e Shkodrës) është një ndër zonat më të goditura nga diktatura komuniste, qoftë në të dënuar, internuar, ekzekutuar, vrarë në kufi, përballur me sistemin, me gjyqe dhe ekzekutime publike deri në vitin 1990, kur dy të mitur pa mbushur 18 u vranë në kufi dhe u ekspozuan në të gjithë qytetin e trupat e tyre u keqtrajtuat, për t'u bërë shembull për të tjerët.

Sistemi komunist ndërmoi jo pak fushata dhune për ta shtruar këtë zonë rebele, që nga masakra e Tamarës, fushatat e egra me dhjetëra burgje të improvizuara në qytet pas kryengritjes së Postribës e në vijim, të gjitha me pasoja tragjike për zonën, traumë që Shkodra e vuan ende sot.

Qendra MEMO



MEMO dhe MAM do të realizojnë një projekt për mbajtjen gjallë të kujtimit të fëmijëve të zhdukur në kampin e internimit të Tepelenë, nismë e lobuar që në krijimin e MEMO-s.

Projekti ndihmon në formësimin e kujtesës historike për kampin e internimit me tela me gjemba në Tepelenë, përmes kërkimit të fëmijëve që humbën jetën atje dhe zhvillimit të aktiviteteve ndër-gjegjësuere që promovojnë respektimin e të drejtave të familjeve të fëmijëve të zhdukur.

30 vjet pas shembjes së regjimit totalitar në Shqipëri, historia vijon të zbulojë faktet, vendet, njerëzit. Ligjërimi gjithëpërfshirës publik për mohimin e të drejtave të njeriut duhet bazuar në hulumitime të mëtejshme. Po ashtu, ka mungesa të theksuara në dokumentimin e krimeve makabre dhe mungon një strategji kombëtare për ta përkujtuar të shkuarën.

Ky është rasti i kampit të punës së detyruar në Tepelenë (1949-1952) - një vend i harruar në ligjërimet historike dhe tekstet shkollore - ku rreth 300 fëmijë humbën jetën nga kushte të vështira dhe ende nuk ka një pllakë varri me emrin e tyre. Familjarët e fëmijëve të zhdukur kanë të drejtë të dinë për ta, si dhe të mbështeten e përfshihen në proceset e hetimit dhe dokumentimit të së shkuarës.

Fashion Design Alb

E themeluar në 2008, Fashion Desing Alb ka marrë pjesë në nisma mbi trashëgiminë kulturore, artin dhe edukimin e të rinjve.

Projekti "Kujtesa e humbur në tre dimensione" synon të krijojë një ekspozitë audiovizuale, në të cilën do të improvizohet skena e një dhome izolimi, ku do të paraqiten imazhe vizuale, veshje, sende personale, shkrime fotografike të të dënuarve, hetuesve, oficerëve, policëve dhe civilëve, si dhe sende pune apo mjete policore që evokojnë periudhën e diktaturës.

Të tre sfondet e ekspozitës do të paraqesin emrat e personave të zhdukur gjatë regjimit komunist në Shqipëri, mes të cilëve, Galip Hatibi, Trifon Xhagjika dhe Hito Sadik (Emini). Ekspozita do të qëndrojë hapur përgjatë një jave në mjediset e Universitetit European të Tiranës.

Instituti për Aktivizëm dhe Ndryshim Social



Instituti për Aktivizëm dhe Ndryshim Social aktualisht punon me projekte që kanë në qendër të drejtat e njeriut, situatat e konfliktit, reformën në sistemin e drejtësisë, përfshirjen e të rinjve në proceset tranzitore, etj.

E drejta për të vërtetën është koncept ligjor që në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar ka të bëjë me detyrimin e shtetit për të siguruar informacion për viktimat ose për familjet e tyre apo edhe shoqërinë në tërësi, në lidhje me rrethanat që shkelin të drejtat e njeriut.

Një e drejtë e tillë duhet të përmbushet dhe shkon përtej përcaktimit të fajësisë apo pafajësisë së individëve të veçantë. E drejta për të vërtetën nxitet nga qëllime të tilla të larta si kontributi në "rivendosjen dhe ruajtjen e paqes" dhe "procesi i pajtimit kombëtar", të tilla si lufta ndaj pandëshkueshmërisë, parandalimi i shkeljeve në të ardhmen, përmbushja e kërkesave të viktimave, nevojat dhe përkrahja e të drejtave të tyre, largimi i figurave me rrezikshmëri nga skena politike, rivendosja e sundimit të ligjit dhe riafirmimi i parimit të ligjshmërisë.

Projekti është një mundësi unike për të rritur pjesëmarrjen në proceset tranzitore dhe të pajtimit për familjet e personave të zhdukur gjatë komunizmit në Shqipëri.

Ai fuqizon qasjen monitoruese të të drejtave të njeriut nga aktorët e shoqërisë civile përballë informacionit shtetëror dhe siguron mundësi për rrjetëzim dhe veprime të përbashkëta për kauzën.

Qendra për Nisma Rajonale



E themeluar në 2015, Qendra për Nisma Rajonale ka zhvilluar projekte mbi drejtësinë, demokracinë, marrëdhëniet me komunitetin dhe mjedisin, me përfshirjen e të rinjve.


Projekti “Kujtesa e sapolindur” do të punojë për formësimin e kujtesës kolektive shqiptare të të rinjtë. Takime me të rinjtë në zonën e Maliqit do t’i informojnë për historinë gjysmëshekullore në regjimin komunist në zonën ku jetojnë

dhe pasojat e saj në të tashmen dhe të ardhmen e vendit, për t’i edukuar me kulturë demokratike dhe ndjenjën e përgjegjësisë në shoqëri.

Është e rëndësishme përfshirja e rinisë në qasjen historike, si edhe mënyra se si shihet e kaluara dhe mbi të gjitha, pesha që ajo mbart, me qëllim që të mos përsëritet, duke i orientuar të rinjtë në politika të përfshirjes, si kategoria ku duhet punuar më shumë, pasi ata do të jenë e ardhmja e shoqërisë europiane.

Prezantohet draftudhëzuesi për familjarët e të zhdukurve në komunizëm,

në kuadër të projektit ICMP-AIDSSH





Më 18 mars, u prezantua draftudhëzuesi për familjarët e të zhdukurve në komunizëm, në kuadër të projektit ICMP-AIDSSH “Rritja e ndërgjegjësimin të publikut për drejtësinë tranzicionale dhe të pajtimit: të zhdukurit në komunizëm”, të mbështetur nga Bashkimi European.

Drafti i udhëzuesit konsultohet me institucionet publike: Ministria e Brendshme, Policia e Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme, Akademia e Studimeve Albanologjike, Avokati i Popullit, etj, organizatat e të drejtave të njeriut, të kujtesës dhe shoqërisë civile; Kujto.al, Qendra Shqiptare e Traumës dhe Torturës, Instituti për Aktivizëm dhe

Ndryshim Social, etj, dhe partnerët ndërkombëtarë, si Prezenca e OSBE-së, Ambasada gjermane, Fondacioni Konrad Adenauer, Ambasada Amerikane, etj.

Sugjerimet e palëve mbi udhëzuesin do të ndihmojnë për finalizimin e tij dhe prezantimin në të gjithë vendin, për familjarët dhe të afërmit e të zhdukurve në komunizëm.


Sipas ligjit 45/2015, “Autoriteti bashkëpunon me institucionet shtetërore qendrore dhe vendore për procesin e identifikimit dhe rikuperimit të trupave të atyre që u zhdukën ose u ekzekutuan gjatë komunizmit, si dhe për marrjen e masave për të mbrojtur dhe ruajtur në mënyrën më të përshtatshme vendet që janë aktualisht apo do të identifikohen si vendvarrime.”



Organizohet workshopi online "Përvoja në punën me sistemet e arkivave digjitale dhe proceset digjitalizuese", me IPN polake

Më 26 mars, AIDSSH në bashkëpunim me Arkivin e Institutit Kombëtar të Kujtesës në Poloni zhvilluan workshopin online "Përvoja në punën me sistemet e arkivave digjitale dhe proceset digjitalizuese".

Topografia e dokumenteve, qarkullimi dhe përdorimi nëpërmjet sistemit, ruajtja, siguria e të dhënave, siguria e sistemit, digjitalizimi, përshkrimi i dokumenteve dhe çështjet e aksesit u diskutuan me homologët polakë, në kuadër të ngritjes së infrastrukturës digjitale të AIDSSH dhe shërbimeve TIK në ndërtesën e re të institucionit.



Vizitë e përfaqësisë së Federatës Panshqiptare “Vatra” në AIDSSH

Më 21 prill 2021, një përfaqësi së Federatës Panshqiptare “Vatra” vizitoi Autoritetin për Informimin për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

Kryetari i “Vatrës”, z. Elmi Berisha, znj. Nazo Veliu, sekretare e shoqatës, Dr. Pashko Camaj, z. Mondi Rakaj, z. Anton Raja dhe z. Adriatik Spahiu, anëtarë të kryesisë, u njohën me veprimtarinë e Autoritetit, shtyllat ku mbështetet puna e institucionit dhe sfidat e përditshme.



Kryetarja e Autoritetit, znj. Gentiana Sula dhe ekipi bënë një pasqyrë të zgjeruar të aktivitetit të AIDSSH, që nga kërkesat individuale, studimore dhe institucionale, te projektet aktuale që institucioni koordinon në bashkëpunim me partnerë dhe përballja me të shkuarën, me të gjitha aspektet e saj që ndikojnë të sotmen e të ardhmen tonë.

Në takim, znj. Sula e vuri theksin edhe në çështjen e mijëra të zhdukurve me forcë në komunizëm dhe veprimtarinë e AIDSSH për qartësimin e fatit të tyre. Përtej hapave konkretë në këtë drejtim dhe projekteve të ndërmarra, po koordinohet me institucionet që të lehtësohet procesi i kërkimit, identifikimit dhe zhvarrimit të viktimave dhe bashkërendohet puna e gjithsecilit.

AIDSSH dhe “Vatra” bashkëpunojnë që kur institucioni u krijua, bashkëpunim që është konsoliduar me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Autoritetit në aktivitete të ndryshme të diasporës në SHBA, të organizuara nga “Vatra”. Po ashtu, zbatimi i projektit të dëshmimeve gojore mbi përndjekjen e komunitetit shqiptar në Shtetet e Bashkuara, të realizuara në marrëveshje me Zërin e Amerikës.



Fusha të tjera u propozuan për ta zgjeruar këtë bashkëpunim, duke përfshirë mbështetjen e studimeve mbi të shkuarën komuniste, bazuar në dokumente arkivore, përkrahjen e nismave për kthimin në vendkujtese të vendeve të vuajtjes së dënimit dhe ndëshkimit gjatë diktaturës, mbështetjen e iniciativave për qartësim të rolit të propagandës gjatë regjimit dhe dizinformimit të shoqërisë përmes mjeteve të komunikimit publik, qasje në arkiva personale dhe institucionale që ndihmojnë plotësimin e kuadrit historik të periudhës 1944-1991, etj.


Për sa më sipër, Autoriteti u ftua të njohë e prezantojë projektet e veta, po ashtu të bashkëpunojë me “Vatrën” dhe komunitetin shqiptar në SHBA, duke u dhënë jetë propozimeve për bashkërendim aktiviteteve.

Autoriteti ka vënë në dispozicion të Vatrës dosjet në tre vëllime të Sigurimit të Shtetit, që e survejoi për gjysmë shekulli organizatën, duke mbledhur mbi 800 faqe informacione për anëtarët e saj dhe komunitetin shqiptar në SHBA.

Një studim i zgjeruar për historikun e Federatës Panshqiptare “Vatra” po përgatitet, i cili do të hedhë dritë në dokumente arkivore dhe ngjarje ku “Vatra” ka luajtur rol të rëndësishëm.

Dosjet për “Vatrën” janë pjesë e fondit të dokumenteve arkivore që përmbajnë dhe trajtojnë informacione e të dhëna rreth emigracionit politik shqiptar, të arratisurve jashtë vendit, grupeve diversante, organizatave të ndryshme politike të krijuara nga emigracioni shqiptar në Europë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vende të tjera. Dokumentet ruhen si raporte, statistika dhe informata mbi veprimtarinë e emigracionit shqiptar në vende të ndryshme, relacione dhe raporte mbi bandat e diversantët që operonin kryesisht në Jugosllavi, etj., relacione dhe statistika për të arratisurit, të dhëna dhe dosje për emigrantët politikë e ekonomikë, etj., në arkivat e Autoritetit.





Dokumentet përlogariten të jenë afërsisht 90 mijë dosje e fashikuj dhe i përkasin periudhës 1944-1991; një pjesë e mirë e tyre janë bërë publike për herë të parë për qytetarët dhe studiuesit në konferencën ndërkombëtare shkencore me temë “Emigracioni politik shqiptar në vitet 1944-1990”, të mbajtur më 19 shkurt 2019 nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet

e ish-Sigurimit të Shtetit, në bashkëpunim me Institutin e Historisë pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike, Institutin për Studimin e Krimeve dhe Pashojave të Komunizmit, Institutin për Integrimin e ish-të Përndjekurve Politikë, Muzeun Historik Kombëtar, Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Europës, ku një pjesë e mirë e tyre u vunë në dispozicion të studiuesve, dhe u ekspozuan për të interesuarit, në bashkëpunim me MEPJ.



Nënshkruhet marrëveshja e bashkëpunimit mes AIDSSH dhe Akademisë së Studimeve Albanologjike

Më 23 prill, në mjediset e ASA, u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit midis Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe Akademisë së Studimeve Albanologjike, mes znj. Gentiana Sula, Kryetare e Autoritetit dhe akademikut prof. dr. Marenglen Verli, Rektor i ASA.

Objekt i marrëveshjes është institucionalizimi i marrëdhënieve për aplikimin e procedurave që thjeshtojnë bashkëpunimin e ndërsjellë të palëve, në kuadër të mbështetjes së kërkimit shkencor gjatë rishqyrtimit historik të veprimtarisë represive të regjimit komunist dhe veçanërisht të ish-Sigurimit të Shtetit, nëpërmjet garantimit të mundësisë për shqyrtimin e dokumenteve dhe

dorëzimin e dublikatave të dokumenteve, veçanërisht në formimin universitar të thelluar të studentëve.



“Marrëveshja me ASA konsolidon bashkëpunimin me institutet e saj, duke shfrytëzuar ekspertizën përkatëse, sa i takon studimeve historike, shoqërore, kulturore, etj., të periudhës 1944-1991, edhe në trajtim enciklopedik, të lidhur me përndjekjen në komunizëm, format e opozitarizmit dhe kundërshtisë me regjimin, figurave të mirënjohura intelektuale, përvojave dhe proceseve të ekspertizës të antropologjisë dhe arkeologjisë, edhe sa u takon të zhdukurve në komunizëm,” u shpreh Kryetarja e Autoritetit,

znj. Sula. Sipas prof. dr. Marenglen Verli, Rektor i ASA, “marrëveshja nxit dhe mbështet realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore dhe të edukimit qytetar për demokraci. Po ashtu, të veprimtarive të tjera shkencore (konferenca, seminare, tryeza, studime, botime, intervista e dokumentarë në fusha me interes të dyanshëm), duke ndihmuar zbardhjen e së shkuarës komuniste”.

AIDSSH dhe ASA do të punojnë për hartimin e planeve të përbashkëta vjetore për aktivitete të kalendarit të kujtesës, në kuadrin e veprimtarive kërkimore shkencore, botimeve, nismave për edukimin qytetar, seminareve, tryezave të punës, etj. Bashkëpunimi dhe hulumtimi në arkiva synon të konsolidojë punën për njohjen e së shkuarës, në funksion të transparencës dhe komunikimit ndërveprues me qytetarët.



NJOHJA NXIT STUDIMIN



Punimet u përgatitën në kuadër të konferencës ndërkombëtare shkencore të AIDSSH, ASA, ISKPK, *“Të mohuar nga regjimi: burgjet, sistemi i internim-dëbimeve dhe puna e detyruar në Shqipëri, 1944-1990”*.

Interesi publik në Shqipëri: Ballafaqimi me të shkuarën komuniste në kontekstin e integritimit evropian

Sara Çapaliku

unimi u përgatit nga studiuesja Sara Çapaliku, juriste, Procesi i hapjes së dosjeve dhe zbatimi i ligjit të lustracionit krahasohet me përvojën e implementimit të këtij ligji në Gjermaninë Lindore dhe Poloni. Pyetjet kërkimore bazohen kryesisht në aspektin pragmatist dhe realist të hapjes së dosjeve, si dhe në atë të vlerave e moralit, parë edhe nga këndvështrimi i aktorëve ndërkombëtarë e opinionit i shoqërisë civile.

Në aspektin profesional, ky punim studimor vjen si vazhdimësi e hulumtimeve të mëparshme. Gjithashtu, përfaqëson interesin në rritje në fushën e drejtësisë, të të drejtave të njeriut dhe edukimit të brezave të rinj mbi mësimet e së kaluarës, për të evituar rrezikun e përsëritjes së historisë.

Me bindjen se komunizmi vazhdon të formësojë dhe brezat e sotëm të tranzicionit, si produkt i një shoqërie të paorientuar mes të shkuarës diktatoriale dhe të ardhmes evropiane, procesi i arritjes në një gjykim të “shëndetshëm” rreth përjasjeve me të shkuarën paraqet një sfidë që na përket....

Problemi i Hoxhës: Trashëgimia komuniste dhe kërkesat e të vdekurit

Lori Amy

Nëse trashëgimia përfaqëson një relike të së shkuarës, përkujtimi përfshin përgjigjen ndaj kërkesave të të vdekurve.

Joost Fontein, *The Politics of the Dead: Living Heritage, Bones and Commemoration in Zimbabwe*
Dua ta shoh sistemin e dëbimit të periudhës 1949-1955 përmes lenteve të trashëgimisë dhe përkujtimit si përgjigje ndaj kërkesave të të vdekurve. Pse trashëgimi, dhe pse përgjigje ndaj kërkesave të të vdekurve?

E fillojmë nga trashëgimia: Këshilli Ndërkombëtar i Monumenteve dhe Siteve (ICOMOS) e përkufizon trashëgiminë kulturore si "shprehje të mënyrave të të jetuarit të zhvilluar nga një komunitet dhe të përcjellë brez pas brezi, duke përfshirë doket, praktikat, vendet, objektet, shprehjet dhe vlerat artistike" (ICOMOS, 2002). Kur e konsiderojmë trashëgiminë kulturore si "mënyrë të të jetuarit të zhvilluar nga një komunitet dhe të trashëguar nga brezi në brez", atëherë shohim që një gjysmë shekulli terrori shtetëror në Shqipëri krijoi në të vërtetë një kulturë – kulturën e spiunimit, burgosjes, torturës, ekzekutimit, punës së detyruar, i udhëhequr nga fantazitë paranojake egomaniake të Enver Hoxhës, të forcuara edhe nga rrethi i tij i brendshëm.

T'ia nisim që këtu: traumat specifike që përjetuan njerëzit nën komunizëm ishin secila pjesë e një cohe kulturore më të madhe, çdo thurje e së cilës ishte e punuar me terror shtetëror. Njerëz të dërguar në gulagë, familjet që jetonin nën shtypjen e biografisë së keqe, ata të shpronësuar, torturuar dhe ekzekutuar – të gjithë janë viktime të dukshme të terrorit shtetëror. Por kjo dhunë specifike mund të ndodhë vetëm në sajë të shtypjes brutale, të mosmarrëveshjeve dhe vrasjes së dhunshme të opozitës së mundshme, të kryer nga arkitektët e terrorit shtetëror dhe agjentët e shtetit. Nga ana e saj, kjo shtypje brutale e terrorizoi pjesën tjetër të popullatës duke u bërë ose mbështetëse bashkëpunuese me regjimin, ose të bindur pasive, me shpresën për të mbrojtur veten...

Mnemozina e topikëve të trishtë letrarë

Agron Tufa

Kujtesa si organ psikologjik i përjetimit të kohës mbetet e vetmja ndërmjetëse që na garanton unitetin e thelbit të qenies, të projektuar në një shkallë vetënjoheje individuale dhe kolektive. E them në një shkallë vetënjoheje, sepse kujtesa, siç e thamë, është organ psikologjik dhe se vetë psikologjia njerëzore, individuale qoftë ajo apo shoqërore, gjendet në kushtet e një trysnie të përhershme që e relativizon, e deformon, e transformon apo e çorodit krejtësisht psikikën njerëzore, po të merren parasysh dramat individuale dhe kolektive.


Psikologjia është e varur nga psikika, pasi kjo e dyta është tregues i shëndetit të së parës. Rrjedhimisht edhe kujtesa, duke qenë organ psikologjik i përjetimit të kohës dhe shprehje vetidentifikuese e totalitetit organik të qenies në kohë, relativizohet, shformohet, manipulohet dhe na prezanton marrtas, në pajtim me thelbin e deformuar të vetes sonë.

Kujtesa e manipuluar është një togfjalësh që shpreh reflektimin kritik, të ndërgjegjshëm e oponencial nga pikëpamja e dikujt që zotëron një përvojë krahasimore në lidhje me origjinën e njohjes dhe gjendjeve stadiale të trajektores së kujtesës, prej nga zë fill tjetërsimi dhe manipulimi i saj. Ky proces nuk ka gjë të përbashkët me idiomën e përvojave individuale "më tradhton kujtesa", pasi si akt ndërgjegjësimit, kjo shpreh riaftësimin dhe ripërfitim të po asaj kujtese vetidentifikuese, për t'u pozicionuar mandej, në masën e vetëdijësimit, për një përbashkë raportesh me të.

Fjala, më konkretisht, është për kujtesën historike apo kolektive, që deri më tash ekziston kryesisht në po ato forma që e mendonin grekët e lashtë, në trajtën e mneme-së, anamnez-isit dhe mnemozinës....

PROFILE DHE RRËFIME

“Shpirtërisht më i qetë jam në burg. Gjithë jeta shqiptare është një burg në në përmasat e kufijve të Shqipërisë. Të jesh i lirë dhe t’i nënshtrohesh diktatit komunist, është vdekje morale.”



Sami Dangëllia

Më 23 prill të 1987, pas 43 vjetësh në burgje dhe internime, mbylli sytë Sami Dangëllia, qëndrestari pa bujë i mbiquajtur “babagyshi”.

I dënuar më 8 nëntor 1945, në moshën 25-vjeçare, nga këshilli gjyqësor ushtarak i Korçës si “armik i popullit” dhe “kriminel luftime”, u lirua në shtator të 1954, dhe dërgua në internim. Më 13 shkurt 1960 u dënua për tentativë arratisjeje me 25 vjet, të cilave iu shtuan 25 të tjera për pjesëmarrje në revoltën e Spaçit.

“Babagyshi” e mbylli jetën në burg në moshën 67-vjeçare, në perëndim të diktaturës.



Atë Daniel Dajani

Më 4 mars 1946 u ekzekutuan në Shkodër martirët Atë Daniel Dajani (1906-1946) prift jezuit, dhe Atë Gjon Shllaku (1907-1946) frat françeskan, arsimtar dhe publicist.

Atë Daniel Dajani lindi në Blinisht të Zadrimës. U arrestua më 31 dhjetor 1945 bashkë me priftin jezuit nga Italia Gjovani Fausti (Beato Giovanni Fausti, Brozzo, 1899 – Shkodër, 1946). Më 22 shkurt 1946, Gjykata e Shkodrës urdhëroi dënimin me vdekje, pushkatim.

Atë Gjon Shllaku lindi në Shkodër, më 27 korrik 1907. Filloren dhe gjimnazin e ulët i ndoqi në vendlindje. Pasi kreu liceun “Illyricum”, u dërgua në Holandë për teologji. Në vitet

1936-1937 doktoroi për filozofi në Universitetin e Sorbonës në Paris. Pas studimeve u kthye në atdhe, ku ishte drejtor i “Hyllit të Dritës”. Në janar 1946 u arrestua nga regjimi komunist dhe u dënua me vdekje.

Atë Daniel Dajani dhe Atë Gjon Shllaku u shpallën martirë të Kishës Katolike, në nëntor 2016.



Gjeto Vocaj

“Nëse doni të ndoheni gjithnjë mire mes njerëzve, kërkojeni me ngulm dritën, e cila ju ndriçon mendjen, se po mbetet në errësirë, edhe hija juaj do t’ju braktisë...”

Në 1962, një mësues i pasionuar, i nxitur nga aftësitë matematikore të një fëmije 6-vjeçar nga Dukagjini, shkroi artikullin “Fëmijë jo i zakonshëm” për gazetën “Mësuesi”. Kureshtja dhe diskutimet që ngjalli shkrimi në shoqërinë e kohës u pasuan nga takimi me Enver Hoxhën, që e ndryshoi jetën e fëmijës gjeni dhe mësuesit “zbulues”. Pas takimit, ngjarjet që pasuan e kapërcyen fatin e individit, i cili u “bashkua” armiqve të pushtetit dhe zbuloi në vetë të parë anën tjetër të sistemit, në burgjet ku vuajti dënimin.

Përballjen me sistemin, mësuesi Gjeto Vocaj e rrëfen në librin "Takim fatal me diktatorin", i botuar në vitin 2009, përkthyer edhe në gjuhën angleze, duke pasuruar fondin e librave që dokumentojnë të shkuarën komuniste.

Mësuesi Vocaj ka dhënë dëshminë e tij edhe për projektin “Edhe muret kanë veshë”, dëshmi që ruhet në AIDSSH, krahas materialeve që sistemi prodhoi për të.

Gjeto Vocaj lindi në Mirditë dhe u arsimua në Tiranë. I diplomuar për matematikë, punoi si mësues në disa shkolla të Shkodrës dhe në zona të thella malore. Në vitin 1962 jeta e tij ndryshoi, nga mësues, në armik të popullit, i hetuar, survejuar, me familjarë të dënuar në kampet e punës së detyruar, burg e internim. Pas rënies së sistemit, Vocaj iu rikthye punës në arsim.

Në vitin 1993 u vlerësua me Urdhrin “Naim Frashëri” nga Presidenti i Republikës.



Fatbardha Mulleti Saraçi

E lindur në Tiranë, më 1939, Fatbardha Mulleti Saraçi, me histori të gjatë familjare dhe personale të përndjekjes e survejimit me ndryshimin e sistemit në agim të viteve '90, u investua e tëra në dokumentimin e krimit komunist dhe mbijetesën e nënave, grave, e motrave të të dënuarve politikë, duke sjellë në të sotmen dëshmi të zonjave nga burgjet, kampet, fshatrat e internimit, sidomos të kampit të Tepelenës.

Shumë prej të intervistuarave të Fatbardhës sot nuk jetojnë më. Vëllimet e saj me dëshmi, “Dhimbje”, “Kalvari i grave në burgjet e komunizmit” dhe “Saga e dhimbjes”, botuar nga ISKK, janë kontribut i vyer për shoqërinë e sotme, duke sjellë pa bujë fytirat e panjohura të grave e motrave të internuara, ndëshkuara, dënuara, përcmuara e anatemuara në kushtet e luftës së klasave.

Në qershor 2017, Presidenti i Republikës e nderoi znj. Saraçi me titullin e lartë “Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut”.

Fatbardha Mulleti Saraçi ka dhënë dëshminë e vet për AIDSSH, duke iu referuar edhe shumë ngjarjeve të jetuara apo të rrëfyera nga të mbijetuarat. Aktive edhe sot, Fatbardha vazhdon të kërkojë drejtësi në përballjen me të shkuarën.



Etëhem Haxhiademi

Dramaturgu dhe poeti Etëhem Haxhiademi (1902-1965) lindi në Elbasan më 8 mars 1902. Pas vendosjes së regjimit komunist në vend, u arrestua si armik i popullit dhe mbështetës i Ballit Kombëtar, dhe u dënua me vdekje, dënim që iu zëvendësua me burgim të përjetshëm, që e kaloi në burgjet e Elbasanit, Gjirokastrës, për ta përfunduar në Burrel. Sipas kujtimeve të Makensen Bungos, poeti, tragjediani, anëtari i Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë, profesori i Normales së Elbasanit, Etëhem Haxhiademi, pas torturave “ishte dobësuar e tretur, ishte kërrusur dhe mezi ecte. Ishte transformuar, që të vinte keq ta shihje. Kur e kthyen në

Elbasan për ta gjykuar, nuk e njoha. Ishte plakur shumë”.

Bungo e sjell Haxhiademin përmes kujtimeve të Atë Konrad Gjolajt, që jetoi me të në burgun e Burrelit: “Kam ndejë 6 vjet me të. Shumë i sjellshëm. Ishte me parime moderne. Aspak fanatik, jofetar. Kishte dijtë me i ba ballë “krymave të burgut”. Kishte shoqëni të gjanë dhe konsiderohej prej të gjithëve zotni. Ashtu ishte. Nuk gabonte kurrë kur i ndante njerzit ndër të kulturuem dhe të pa kulturë. Ishte qefli diskutimesh në të gjitha fushat dhe e kalonte kohën gjithmonë tue lexue, bile edhe shtrimë ratë. Diskutimet i kishte koncize dhe me logjikë. Pranonte gabimet e dinte edhe me lypë të falun, gjithmonë tue u bazue tek e drejta.”

Themeluesi i tragjedisë shqiptare me veprat “Ulisi”, “Akili”, “Aleksandri”, “Pirrua”, “Skënderbeu”, “Diomedi” dhe “Abeli”, njohësi i mirë dhe përkthyesi në burg për gati 20 vjet i greqishtes së vjetër, latinishtes, gjermanishtes, turqishtes, intelektual i dalluar për kulturën klasike, mbylli sytë në Burrel, më 17 mars 1965.

Ende sot, Etëhem Haxhiademit nuk i dihen eshtrat.

Vinçenc Prennushi



Poet, folklorist dhe përkthyes, Prennushi lindi në Shkodër më 4 shtator 1885. Studioi në kolegjin katolik në Austri. Më 25 mars 1908 u shugurua prift françeskan. Më 1940 u emërua kryepeshkop i Durrësit, duke u bërë një nga dy dinjitarët më të lartë të Kishës Katolike në Shqipëri.

Mblodhi këngë popullore nga fiset veriore të Shqipërisë. Përmbledhjen e një materiali folklorik ia botoi arkeologu dhe historiani austriak, një prej profesorëve të Egerem Çabejt (1908-1980) – Karl Paç (Carl Patsch, 1865-1945) në “Kangë popullore gegnishte”, Sarajevë 1911.

Prennushi botoi artikuj në shtypin katolik të kohës si “Lajmtari i Zemers t’Jezu Krishtit”, “Hylli i Dritës”, “Posta e Shqypniës” dhe “Zani i Shna Ndout”. Më 1924 botoi në Shkodër vëllimin me poezi lirike “Gjeth e lule”. Përmbledhja

përmban gjashtëdhjetë e pesë poezi me frymëzim kombëtar e fetar. Përktheu në shqip romanin me temë nga historia romake “Quo vadis?” (1894-1896), Shkodër 1933, të shkrimtarit polak, fituesi i Çmimit Nobel (1905) Henrik Sjenkjeviç (Henryk Sienkiewicz, 1846-1916). Përktheu edhe krijues gjermanë e italianë.

Ndonëse nuk ishte aktiv në politikë, u arrestua nga regjimi komunist me akuzën “për faje kundra popullit e shtetit, për lidhje me grupet tradhtarë, organizatën demokristiane, agjentët anglo-amerikanë, kriminelët e arratisur dhe gjithë klerikët reaksionarë katolikë” dhe u dënua nga gjykata ushtarake në Durrës si armik i popullit, me njëzet vjet burg e punë të rëndë.

Vinçenc Prennushi u shpall i lumë nga Kisha Katolike më 5 nëntor 2016 në Shkodër, mes 38 martirëve të regjimit komunist, duke vlerësuar jetën e tyre, qëndresën, virtytet njerëzore e shpirtërore dhe mesazhin e dëshmisë së tyre për të sotmen.



Isuf Luzaj

Isuf Luzaj u largua nga Shqipëria më 28 nëntor 1944, me shumë prej drejtuesve të Ballit Kombëtar, duke lënë në Kaninë gruan me 5 fëmijë të mitur. Komisioni për Krimet dhe Kriminelët e Luftës, në 1945 e quajti “tradhëtar me damkë dhe kriminel të mirënjohur”. Familja e prof. Luzajt, e mbetur në Shqipëri, u persekutua ashpër nga regjimi. Të gjithë u internuan, dhe vajza e vogël 1-vjeçare vdiq në kampin e përqendrimit në Fushë-Krujë për mungesë të ilaçeve kundër tuberkulozit.


Ndërkohë, jeta e profesor Luzajt në emigracion nuk ishte e lehtë. Në Itali u arrestua me akuzën se ishte atentatori i gjeneral Zaninit, i cili kishte vrarë Qazim Koculin, heroin e Luftës së Vlorës dhe një nga figurat më me influencë në Vlorë. Gjykata italiane e dënoi me

burgim të përjetshëm, i cili u amnistua pas pak kohësh. Me rekomandim të Sandro Pertinit, punoi më tepër se 2 vjet në Bibliotekën e Vatikanit dhe, më pas u vendos në Breshia, ku dha mësim latinisht në një seminar pranë qytetit. Më 1948, u largua drejt Argjentinës, ku filloi karrierën si përkthyes pranë Ministrisë së Arsimit, më pas si pedagog në Universitetin e Buenos Airesit dhe këshilltar në Ministrinë e Arsimit.

Pas vdekjes së Ali Këlcyrës (1963), përfaqësues të Ballit Kombëtar në SHBA e thirrën për të marrë drejtimin e organizatës. Në kongresin e mbajtur në Nju Jork, prof. Luzaj u zgjodh kryetar i Ballit Kombëtar në emigracion.

Për 40 vjet me radhë, përtej sukseseve profesionale dhe vlerësimeve deri nga Presidenti i SHBA, profesor Luzaj mbajti korrespondencë të pandërprerë me Dritën, të shoqen e shumëvujtur që, bashkë me fëmijët, kaloi kalvarin e përndjekjes dhe shtypjes nga regjimi.

Dosja formulare e prof. Isuf Luzaj është deklasifikuar dhe është trajtuar në studimin për të, në kuadër të projektit “Mendimi politik i së majtës” i FES me AIDSSH.



Ndre Zadeja

Ndre Zadeja lindi më 3 nëntor 1891. Ndoqi kolegjin jezuit në Shkodër. Për kualifikim fetar u dërgua në Insbruk. Me t’u kthyer në Shqipëri, u emërua sekretar i kryepeshkopit të Shkodrës, Jak Serreqi. Më vonë qe famullitar në disa fshatra të Shqipërisë së veriut. Shkroi poezi, një pjesë e të cilave u botuan, si ajo drejtuar bashkëkohësit, studiuesit jezuit Fulvio Kordinjano (Fulvio Cordignano, 1887-1952).

Zadeja është autor i pjesëve teatrale me frymë kombëtare, me temë historike dhe legjendare, që në vitet ’20 e ’30 të shekullit XX u vunë në skenë në Shkodër, mes të cilave melodrama “Ora e Shqipnis” (1919); “Hijet e zeza” (1921), legjendë që u shfaq më 1921; “Ruba e kuqe” e shfaqur më 1937; melodrama

“Rozafa” e shfaqur më 1936; pjesa me temë patriotike “Rreth flamurit”; “Shpella e Bogdanit”; “Rrethimi i Shkodrës 1477-1478” e shfaqur më 1937.

Poeti e dramaturgu Zadeja u arrestua më 4 shkurt 1945, me akuzën e strehimit të Dom Lazër Shantosë “element kryengritës” e “reaksionar”, dhe u ekzekutua më 25 mars.

Dom Ndre Zadeja u shpall i lumë nga Kisha Katolike më 5 nëntor 2016 në Shkodër, mes 38 martirëve të diktaturës.